



Republika e Kosovës - Republika Kosova
Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborna komisija za žalbe i molbe

A nr. 26/2009

Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, në panelin e përbërë nga Osman Tmava, kryesues, Fahredin Ymeri dhe Muharrem Shala, anëtarë, përkitazi me ankesën e z. Ilaz Avdili nga Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), dega në Shtërpcë, në seancën e mbajtur më datë 26.10.2009, mori

VENDIM

Ankesa refuzohet si e pabazuar.

ARSYETIMI

Z. Ilaz Avdili nga PDK - dega në Shtërpcë, ka parashtruar ankesë me të cilën pretendon se Drejtori i Departamentit të Shëndetësisë, Tefik Islami, njëherësh kandidat për Kryetar të Shtërpcës nga radhët e Lidhjes Demokratike të Dardanisë (LDD), ka bërë fushatë dhe propagandë gjatë orarit të punës, dhe ka prerë shirita në përrurim të ambulancës në fshatin Brod, më 21 Tetor 2009.

FAKTET

Më 21 tetor 2009, Komisioni për Ankesa dhe Parashtresa (KZAP) ka pranuar një ankesë nga z. Ilaz Avdili nga PDK - dega në Shtërpcë, pretendon se Tefik Islami, drejtor aktual i Departamentit të Shëndetësisë dhe kandidat për kryetar komune nga LDD, ka shkelur Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP), siç parashihet në nenin 35.1, duke zhvilluar fushatë elektorale për veten dhe subjektin e vet politik. Gjithashtu, pretenduesi ofron si fakte incizimin e ngjarjes në TV Tema – Ferizaj. Për më tepër, ankuesi deklaroi se më 21 tetor 2009, ora 11 në Brod, ky kandidat për kryetar komune ka prerë shirita dhe ka propaganduar gjatë orarit të punës, në përrurim të ambulancës së këtij fshati.

ANALIZË

Jurisdiksioni i KZAP'it lidhur me ankesat është caktuar në pajtim me kompetencat e dhëna nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në *Ligjin mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës – LZP* (Ligji nr 03/L- 073) dhe *Ligjin për Zgjedhjet Lokale në Republikën Kosovës* (Ligji nr 03 / L-072).

KZAP-i vlerëson se Ankesa është e parregullt për faktin se nuk përmban të gjitha elementet e domosdoshme të parashikuara me dispozitën 3.5 dhe 3.6 të Rregullave dhe Procedurave të KZAP-it, përkatësisht Ankesa nuk është nënshkruar nga pala.

Për këto arsye, bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

A nr. 26 /2009 më datën 26.10.2009.

